



Buletini mujor

Shkurt 2026



Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu zhvillon takim zyrtar me Ambasadorin e Holandës në Shqipëri, Sh.T.Z. Reinout Vos

Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Arben Shehu, në datë 19.02.2026, zhvilloi një takim zyrtar në ambientet e KLSH-së me Ambasadorin e Holandës në Shqipëri, Sh.T.Z. Reinout Vos.

Gjatë këtij takimi u diskutua mbi bashkëpunimin ndërinstitucional midis Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe institucionit homolog holandez, Algemene Rekenkamer (*Gjykata e Llogarive e Holandës*). Ky bashkëpunim, i mundësuar me mbështetjen e Ambasadës së Mbretërisë së Holandës në Tiranë, synon të forcojë shkëmbimin e eksperiencave, praktikave më të mira të auditimit dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale për të rritur transparencën, integritetin dhe menaxhimin efektiv të financave publike në Shqipëri.

Ambasadori Vos shprehu vlerësimin e tij për punën dhe kontributin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, veçanërisht në forcimin e rolit të institucionit në nivel ndërkombëtar përmes bashkëpunimeve me institucione homologe dhe organizata ndërkombëtare të auditimit.

Ambasadori Vos vlerësoi gjithashtu bashkëpunimet e KLSH-së me Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) dhe Faktejo.al, në kuadër të projekteve të përbashkëta që po zhvillohen me mbështetjen e Ambasadës së Holandës, me synim rritjen e transparencës, llogaridhënies publike dhe forcimin e rolit të shoqërisë civile dhe medias në mbikëqyrjen e përdorimit të fondeve publike.

Biseda ndërmjet Kryetarit të KLSH-së dhe Ambasadorit Vos u përqendrua në zgjerimin e mëtejshëm të bashkëpunimit në fusha me interes të përbashkët institucional, me qëllim rritjen e ndikimit të auditimit të jashtëm publik në përmirësimin e qeverisjes dhe forcimin e shtetit të së drejtës.

KLSH mbetet e angazhuar për të thelluar partneritetet ndërkombëtare dhe për të avancuar standardet e auditimit publik, në shërbim të transparencës, llogaridhënies dhe interesit publik.

Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu pret në takim Avokatin e Popullit, z. Endrit Shabani

Më 17 shkurt 2026, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Arben Shehu priti në ambientet e KLSH-së Avokatin e Popullit të Republikës së Shqipërisë, z. Endrit Shabani. Takimi u zhvillua në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional me fokus llogaridhënien e administratës publike dhe mbrojtjen e interesave të qytetarëve. Gjatë bisedës u theksuan objektivat e përbashkëta institucionale në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese.



Analizat vjetore të veprimtarisë për vitin 2025

Gjatë muajit shkurt, në ambientet e Kontrollit të Lartë të Shtetit u zhvilluan analizat vjetore për veprimtarinë e departamenteve të auditimit dhe drejtorive të tjera për vitin 2025.

Takimet u organizuan me qëllim vlerësimin e ecurisë së auditimeve të realizuara gjatë vitit 2025, analizimin e rezultateve dhe identifikimin e objektivave për përmirësimin e mëtejshëm të proceseve të auditimit dhe të punës institucionale në tërësi.

Në fjalën e tij, Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu, duke vlerësuar angazhimin dhe rezultatet e arritura gjatë vitit 2025, theksoi rëndësinë e auditimeve të çdo departamenti në rritjen e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit në përdorimin e fondeve publike.

Duke vënë theksin te forcimi i standardeve profesionale, z. Shehu inkurajoi bashkëpunimin ndërinstitucional dhe koordinimin mes audituesish për arritjen e objektivave të përbashkëta institucionale.

Kryetari i KLSH-së, gjithashtu kërkoi nga çdo punonjës përmbushjen e plotë të detyrave institucionale me korrektësi, përgjegjshmëri dhe profesionalizëm.

Gjatë analizave me çdo strukturë u diskutuan edhe prioritetet e punës për vitin 2026, duke përcaktuar objektiva të qarta për rritjen e cilësisë dhe ndikimin e punës audituese në shërbim të transparencës, llogaridhënies dhe interesit publik.



KLSH në Samitin Ndërkombëtar kundër Korrupsionit në Lima, nënshkruan Deklaratën e përbashkët me 21 institucione homologe



Kontrolli i Lartë i Shtetit mori pjesë në Samitin Ndërkombëtar për Luftën kundër Korrupsionit, i cili u zhvillua më 19–20 shkurt 2026 në Lima, Peru, me pjesëmarrjen e Institucioneve Supreme të Auditimit, anëtare të INTOSAI dhe OLACEFS (*Organizata e Institucioneve Supreme të Auditimit të Amerikës Latine dhe Karaibeve*). Samiti shërbeu si një platformë e rëndësishme ndërkombëtare për shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira në forcimin e kontrollit qeveritar përballë korrupsionit ndërkufitar dhe sfidave që burojnë nga zhvillimet e reja teknologjike.

Gjatë sesioneve të samitit u theksua se korrupsioni ndërkombëtar përbën një kërcënim serioz për stabilitetin demokratik, financat publike dhe zhvillimin e qëndrueshëm, duke kërkuar një qasje të koordinuar dhe bashkëpunim të ngushtë mes institucioneve të auditimit.

Diskutimet në tryezat e nivelit të lartë u përqendruan në hartimin e politikave globale kundër korrupsionit, rritjen e rolit strategjik të Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI), përdorimin e analizës së të dhënave, inteligjencës artificiale dhe teknologjive digjitale në proceset e auditimit, si dhe në forcimin e integritetit dhe kontrollit të brendshëm në sektorin publik. Një vëmendje e veçantë iu kushtua bashkëpunimit teknik dhe administrativ ndërmjet institucioneve homologe, me qëllim shkëmbimin në kohë reale të informacionit dhe rritjen e efektivitetit në auditimin e operacioneve ndërkombëtare.

Në përfundim të samitit, përfaqësuesit e 21 SAI-ve, përfshirë KLSH, nënshkruan Deklaratën “*Mbi Forcimin e Kontrollit Qeveritar përballë Korrupsionit Ndërkombëtar dhe Teknologjive të Reja*”, duke rikonfirmuar angazhimin mbi promovimin dhe zhvillimin e politikave globale kundër korrupsionit që forcojnë rolin e tyre strategjik dhe promovojnë kornizat institucionale që lehtësojnë zhvillimin e politikave kundër korrupsionit. Deklarata thekson gjithashtu rëndësinë e pavarësisë së Institucioneve Supreme të Auditimit si një garanci thelbësore për një kontroll efektiv, efikas dhe transparent në shërbim të qytetarëve.



Workshop-i në Suedi për forcimin e cilësisë dhe impaktit të auditimit të performancës

Në datat 16-20 shkurt 2026 u organizua në Stokholm të Suedisë workshop-i për drejtuesit e auditimit të performancës. Qëllimi i seminarit të organizuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë ishte forcimi dhe zhvillimi i aftësisë së drejtuesve për të krijuar kushte që rritin cilësinë dhe ndikimin e auditimeve të performancës. Në këtë workshop morën pjesë drejtues dhe menaxher të SAI-ve të Norvegjisë, Kosovës, Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi, Bosnje dhe Hercegovinës, Serbisë, Moldavisë, Ukrainës, Ugandës, Tanzanisë, Liberisë, Somalisë, Kenias dhe Zimbabves. Kontrolli i Lartë i Shtetit u përfaqësua nga drejtori i Departamentit të Auditimit të Performancës, z. Aulent Guri dhe drejtori i Sigurimit të Cilësisë dhe Zbatimit të Standardeve, znj. Joniada Gocaj.



Gjatë këtij seminary u diskutua në mënyrë të veçantë mbi “sigurinë e psikologjisë” (psychological safety), e cila nënkupton garantimin e një klime bashkëpunuese e mbështetëse duke nxitur diskutimin, dialogun e hapur si dhe ndarjen e mendimeve me qëllim motivimin e stafit dhe gjenerimin e raporteve të auditimit me cilësi dhe impakt për qeverinë dhe publikun.



TAKIMI RAJONAL I PUNËS NË KLSH

“Fuqizimi i rolit të grave në pozita udhëheqëse dhe në marrjen e vendimeve”



Në kuadër të auditimit të përbashkët rajonal mes tri Institucioneve Supreme të Auditimit në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni e Veriut me temë “Fuqizimi i rolit të grave në pozita udhëheqëse dhe në marrjen e vendimeve”, më 12 shkurt 2026, në mjediset e Kontrollit të Lartë të Shtetit u realizua takimi i parë i punës ndërmjet grupeve të auditimit. Auditimi paralel mes Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH), Zyrës Kombëtare të Auditimit në Kosovë (ZKA) dhe Entit Shtetëror të Revizionit të Republikës së Maqedonisë së Veriut (ESHR) po kryhet me mbështetjen e organizatës “UN Women Albania”. Auditimi ka si objektiv kryesor të vlerësojë në mënyrë të paanshme efektivitetin e politikave dhe kuotat gjinore më qëllim nxitjen dhe rritjen e pjesëmarrjes së grave në pozita udhëheqëse dhe vendimmarrëse.

Përfaqësuesit e grupeve të auditimit diskutuan mbi gjetjet paraprake, sfidat e përbashkëta, si dhe përcaktimin e hapave të mëtejshëm drejt fazës së raportimit duke vlerësuar zbatimin e politikave për barazinë gjinore, respektimin e kuotave në procesin zgjedhor dhe përfaqësimin e grave në pozicione drejtuese.

Audituesit evidentuan fenomenet kryesore të hasura gjatë procesit të auditimit. Nga KLSH u theksua se përfaqësimi i grave në Parlament ka tejkaluar pragun 30% në zgjedhjet e vitit 2021 dhe 2025, ndërsa në nivel vendor është evidentuar fenomeni i dorëheqjeve të koordinuara, me ndikim në balancën gjinore.

Diskutimet u fokusuan në forcimin e monitorimit, rritjen e transparencës dhe përmirësimet ligjore për garantimin e zbatimit të kuotave gjinore edhe pas zgjedhjeve.

Enti Shtetëror i Revizionit i Republikës së Maqedonisë së Veriut paraqiti analiza mbi përfaqësimin e grave në nivel qendror, duke theksuar sfidat në pozicionet e larta menaxheriale dhe nevoja për sisteme më efektive monitorimi dhe raportimi të të dhënave gjinore.

Nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës u evidentua hendeku në pozicionet vendimmarrëse në administratën publike dhe u theksua rëndësia e përmirësimit të proceseve të rekrutimit, avancimit në karrierë dhe koordinimit ndërinstitucional, për të mbështetur fuqizimin e grave në pozicione drejtuese.

Grupet audituese diskutuan më tej në përgatitjen për fazën e raportimit, duke identifikuar veprimet kyçe dhe hapat e ardhshëm për finalizimin e auditimit dhe formulimin e rekomandimeve të përbashkëta.

Ky bashkëpunim rajonal synon të forcojë rolin e Institucioneve Supreme të Auditimit në promovimin e barazisë gjinore, transparencës dhe llogaridhënies, duke kontribuar në rritjen e përfaqësimit të grave në pozicionet drejtuese dhe vendimmarrëse në sektorin publik.

Bashkëpunimi KLSH–NAO e Norvegjisë për përditësimin e Manualit të Auditimit të Performancës

Në datat 2-3 shkurt 2026 u zhvillua në mjediset e KLSH-së takimi i punës me ekspertë të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Norvegjisë (*The National Audit Office of Norway - NAO*), i cili kishte në fokus rishikimin dhe përditësimin e Manualit të Auditimit të Performancës. Diskutimet u përqendruan në analizimin e strukturës dhe përmbajtjes së draftit të parë të manualit, me synim forcimin e koherencës metodologjike dhe harmonizimin me standardet dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare të auditimit të performancës. Në mënyrë më të detajuar u trajtuan çështje që lidhen me formulimin dhe përdorimin e kriterëve të auditimit, zhvillimin dhe paraqitjen e gjetjeve, konkluzioneve dhe rekomandimeve, si dhe mënyrat praktike të përdorimit të pyetësorëve, intervistave dhe teknikave të tjera për mbledhjen e evidencave. Vëmendje e veçantë iu kushtua edhe dokumentimit të punës audituese, vlerësimit të mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë së evidencave, si dhe integritetit të analizës së riskut, materialitetit dhe rreziqeve të mashtrimit në të gjitha fazat e auditimit.





Tryezë pune për Nënkomisionin e Auditimit të Sektorit Publik

Në vijim të takimit të zhvilluar në muajin dhjetor 2025, më 17.02.2026 u organizua në Tiranë me mbështetjen e Institutit Kombëtar Demokratik (*National Democratic Institute – NDI*) një tryezë pune për Nënkomisionin Parlamentar për Auditimin e Sektorit Publik dhe Kontrollin e Lartë të Shtetit, me fokus harmonizimin e punës mes dy institucioneve me qëllim dhe rritjen e zbatueshmërisë së gjetjeve të auditimit dhe forcimin e llogaridhënies në menaxhimin e financave publike.

Në takim morën pjesë kryetarja e Komisionit për Ekonominë, Punësimin dhe Financat, znj. Milva Ekonomi, kryetari i Nënkomisionit për Auditimin e Sektorit Publik, z. Igli Cara si dhe anëtarë të tij, përfaqësues të KLSH-së, NDI-së etj. Gjithashtu, në tryezë ishin të pranishëm një përfaqësues nga Delegacioni i BE-së për “Kapitullin 32”, si dhe përfaqësuesi i SIGMA/OECD, z. Alastair Swarbrick dhe përfaqësuesi i NDI-së, z. Anthony Staddon.

Takimi u hap nga Drejtuesja e NDI Albania, znj. Ana Kovacevic Kadovic, e cila theksoi se në vijim të diskutimeve të mëparshme nevojitet krijimi i një qasjeje të përbashkët për rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe rritjen e zbatueshmërisë së rekomandimeve të raporteve të auditimit.

Në takim u diskutua mbi zbatimin e mekanizmave praktikë të bashkëpunimit ndërinstitucional midis Nënkomisionit dhe KLSH-së, duke u bazuar në standardet ndërkombëtare dhe kuadrin ligjor shqiptar.

Përfaqësuesit nga SIGMA/OECD dhe NDI paraqitën disa nga praktikatat e mira për një bashkëpunim efektiv midis Parlamentit dhe KLSH-së, duke u fokusuar në mekanizma praktikë, përzgjedhjen e një raporti auditimi për shqyrtim, hapat konkretë për ndjekjen e rekomandimeve të auditimit etj. Ata theksuan se dëgjuesat publike janë instrumenti kryesor i llogaridhënies publike dhe se forcimi i bashkëpunimit mes dy institucioneve në funksion të mbikëqyrjes parlamentare efektive dhe me ndikim publik mbetet prioritet edhe në kuadër të negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Kjo tryezë shërbeu gjithashtu për të përcaktuar prioritetet e punës në vijim të Nënkomisionit dhe për të forcuar transparencën në proceset mbikëqyrëse.



BASHKËPUNIMI KLSH-FAKTOJE.AL

Nis projekti “E vërteta përtej shifrave” për forcimin e ndikimit publik të auditimit

Më 25 shkurt 2026, në ambientet e hotel “Xheko Imperial” Tiranë u zhvillua tryeza e diskutimit “E vërteta përtej shifrave” (Truth Beyond Numbers), aktivitet që shënon nisjen zyrtare të projektit dyvjeçar të zbatuar nga organizata Faktoje.al, me mbështetjen e programit MATRA të Ambasadës së Holandës në Tiranë.

Ky projekt, i cili realizohet në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe organizatës Faktoje.al, synon rritjen e ndikimit të gjetjeve të auditimit në debatin publik, duke i kthyer gjetjet e auditimit në informacione të kuptueshme dhe të dobishme për qytetarët përmes raportimit analitik dhe të advokojë për reforma në politikat publike.

Në aktivitet morën pjesë znj. Klodiana Kapo, Drejtore Ekzekutive e Faktoje.al, Sh.T.Z. Reinout Vos, Ambasadori i Holandës në Shqipëri, deputetë nga komisionet parlamentare të Kuvendit të Shqipërisë, përfaqësues nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, ekspertë të fushës së financave publike, shoqërisë civile dhe medias.

Drejtoresha Ekzekutive e Faktoje.al, Klodiana Kapo, në fjalën e saj theksoi rëndësinë e këtij bashkëpunimi për të përçuar në publik problemet, fenomenet dhe përgjegjësinë institucionale mbi gjetjet e auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Ambasadori i Holandës në Tiranë, Sh. T. Z Reinout Vos, gjatë fjalës së tij theksoi rëndësinë e këtij projekti që ka si qëllim forcimin e institucioneve, llogaridhënien dhe informimin e qytetarëve në mënyrë të thjeshtë, të kuptueshme dhe të prekshme nga ana e tyre.



“Institucionet mund të prodhojnë raporte, mbikëqyrje që i përgjigjet nevojave dhe mund të identifikojnë boshllëqe dhe rekomandime në këtë çështje, por nëse këto gjetje mbeten të palexuara, të pashpjegueshme ose të paarritshme për qytetarët, fuqia transformuese është e kufizuar”, tha ambasadori Vos.

K Kontrolli i Lartë i Shtetit rikonfirmoi angazhimin e tij për transparencë, bashkëpunim institucional dhe mbështetje profesionale, në respekt të plotë të pavarësisë institucionale dhe standardeve të auditimit të jashtëm, me synimin që gjetjet e auditimit të kontribuojnë në përmirësimin e politikave publike dhe forcimin e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike.

Auditimet e KLSH-së në Raportin Botëror të Sektorit Publik 2025 nga Kombet e Bashkuara

“Institucionet Supreme të Auditimit dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm” (OZHQ)





Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (*International Organization of Supreme Audit Institutions - INTOSAI*) ka publikuar Raportin Botëror të Sektorit Publik 2025 “Institucionet Supreme të Auditimit dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm”, i cili është përgatitur nga Departamenti i Çështjeve Ekonomike dhe Sociale i Organizatës së Kombeve të Bashkuara (UN DESA).

Raporti i Kombeve të Bashkuara përqendrohet në rolin vendimtar që luajnë Institucionet Supreme të Auditimit (SAI) në zbatimin e Objektivate të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) sipas “Axhendës 2030”. Në raport theksohet se në sistemet kombëtare të llogaridhënies, SAI-t janë në një pozicion unik për t'u ofruar qeverive njohuri dhe rekomandime të bazuara në prova për të përshejtuar zbatimin e OZHQ-ve. “Përmes auditimeve të tyre, SAI-t shpesh prodhojnë informacione kritike mbi efektivitetin e politikave dhe programeve që lidhen me OZHQ-të, njohuri që mund të mos ishin të disponueshme për qeveritë. Duke e hartuar këtë informacion, SAI-t mund të mundësojnë gjithashtu rritjen e angazhimit publik dhe të rritin llogaridhënien e qeverive për veprimet e tyre për të zbatuar OZHQ-të”. Raporti tregon se SAI-t në të gjithë botën japin një kontribut të rëndësishëm në promovimin e transparencës, llogaridhënies dhe menaxhimit efektiv të financave publike. Raporti e bën të qartë se auditimet e OZHQ-ve janë veçanërisht efektive kur rezultatet e tyre përfshihen sistematikisht në proceset e vendimmarrjes politike. Raportet e auditimit nga SAI-t mbulojnë të 17 OZHQ-të me tematika në rritje, si: përgatitja strategjike e qeverive për zbatimin e OZHQ-ve, përafrimi i buxheteve publike dhe borxhit qeveritar me objektivat e qëndrueshme, masat e mbrojtjes ndaj ndryshimeve të klimës, udhëhequr përmes parimit “Leave no one behind” - “Askush të mos mbetet pas”.

Raporti sintetizon gjetjet dhe rekomandimet e auditimit në fusha të ndryshme të OZHQ-ve dhe paraqet shembuj të ndikimit të auditimit në drejtim të përmirësimit dhe avancimit të zbatimit të OZHQ-ve, me fokus të veçantë në vendet më pak të zhvillim. Raporti gjithashtu shqyrton sfidat dhe mundësitë për SAI-t që lidhen me punën e tyre mbi OZHQ-të. Kjo qasje synon të informojë reflektimet kombëtare dhe ndërqeveritare se si të përshejtohet zbatimi i OZHQ-ve deri në vitin 2030. Sfidat më të zakonshme të identifikuara në raportet e auditimit lidhen me boshllëqet në zbatimin e programeve, legjisllacionit, politikave dhe strategjive. Veprimet e pamjaftueshme përmendën gjerësisht me institucione që dështuan të vepronin në përputhje me angazhimet, qëllimet dhe standardet. Për shembull, nevojat e planifikuara të shërbimit nuk ishin përmbushur, mekanizmat mungonin ose nuk ishin shfrytëzuar sa duhet dhe procedurat nuk u ndoqën. Raporti përmend auditimin e kryer nga KLSH mbi “Fuqizimin ekonomik të grave në Shqipëri”, i cili zbuloi se pavarësisht një objektivit prej 70%, vetëm 31% e programeve përfshinin buxhetim të posaçëm ndaj gjinisë dhe se kishte zbatim të kufizuar të politikave që promovonin pronësinë e tokës së grave dhe fuqizimin rural.

Lidhur me nevojën për të dhëna të ndara ndërsektoriale dhe të përshtatshme nga ana kulturore, në raport sillej si shembull auditimi i përbashkët rajonal “Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale nëpërmjet përfshirjes së tyre në tregun e punës”, i kryer nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, Enti Shtetëror i Auditimit të Maqedonisë së Veriut dhe Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës. Përmes këtij auditimi, SAI-t rekomanduan që të dhënat nga programet e zbatuara mbi promovimin e punësimit dhe trajnimin profesional duhet të ndahen sipas gjinisë dhe zonave rurale dhe urbane. “Efektiviteti i sistemit për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje me fokus gratë e abuzuara”, është një tjetër auditim i KLSH-së i përfshirë në raportin e OKB-së. KLSH rekomandoi që njësitë e vetëqeverisjes vendore të hartojnë plane veprimi për barazinë gjinore dhe parandalimin e dhunës.



“Askush të mos mbetet pas” është parimi thelbësor i Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm. Ai përfaqëson angazhimin e të gjitha shteteve anëtare të OKB-së për të zhdukur varfërinë në të gjitha format e saj, për t'i dhënë fund diskriminimit dhe përjashtimit, dhe për të zvogëluar pabarazitë dhe cenueshmëritë që i lënë njerëzit pas dhe minojnë potencialin e individëve dhe të njerëzimit në tërësi.



Rekomandimet

Raporti jep edhe rekomandimet që duhet të marrin në konsideratë qeveritë, institucionet supreme të auditimit, bashkësia ndërkombëtare, përfshirë Kombet e Bashkuara, për të rritur kontributin e SAI-ve në zhvillimin e qëndrueshëm në vitet e ardhshme.

Për qeveritë:

Qeveritë duhet të sigurojnë që SAI-t të kenë rolin e nevojshëm mbikëqyrës në mënyrë efektive dhe të jenë në gjendje të auditojnë çështje komplekse dhe ndërsektoriale që janë karakteristike për OZHQ-të. Pa pavarësi institucionale dhe kapacitet të mjaftueshëm, SAI-t mund të jenë të kufizuara në aftësinë e tyre për të ofruar mbikëqyrje kuptimplote të proceseve që lidhen me OZHQ-të. Qeveritë mund ta shfrytëzojnë më sistematikisht SAI-n në integrimin e përfundimeve dhe rekomandimeve të auditimit në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e strategjive, buxheteve dhe programeve kombëtare të OZHQ-ve.

Për institucionet supreme të auditimit:

INTOSAI, organet e tij dhe SAI-t anëtare mund të vazhdojnë të zgjerojnë punën e auditimit që lidhet me OZHQ-të, duke u bazuar në përvojën e fituar përmes auditimeve të zbatimit të OZHQ-ve dhe duke zgjeruar mbulimin e auditimit në fusha të tjera të OZHQ-ve. Ekziston mundësia për një integrim më sistematik të parimit “Askush të mos mbetet pas” në punën e auditimit. SAI-t mund të vazhdojnë të forcojnë vëmendjen ndaj situatës së grupeve të disavantazuara, ndaj pabarazive në aksesin në shërbimet publike dhe ndaj integritetit të një perspektive të barazisë dhe përfshirjes në të gjitha auditimet.

Konferenca Ndërkombëtare “Inteligjenca Artificiale në Auditimin e Sektorit Publik”

Më 2-3 shkurt 2026 u zhvillua në Abu Dhabi Konferenca Ndërkombëtare “Inteligjenca Artificiale në Auditimin e Sektorit Publik” (AI in State Audit), e organizuar nga Institucioni Suprem i Auditimit të Emirateve të Bashkuara Arabe (UAE Accountability Authority) në bashkëpunim me EUROSAT-in dhe SAI-n e Izraelit.

Konferenca mbledhi drejtues të Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI), ekspertë të shquar ndërkombëtarë dhe përfaqësues të organizatave kryesore globale, për të diskutuar rolin, sfidat dhe ndikimin e “Inteligjencës Artificiale” (AI) në auditimin e sektorit publik në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare.

Konferenca u drejtua nga Presidenti i EUROSAT-it dhe Kontrollori Shtetëror i Izraelit, z. Matanyahu Englman. Duke përmbledhur rëndësinë e konferencës, z. Englman theksoi se ndërsa “Inteligjenca Artificiale” po integrohet gjithnjë e më shumë në administratën publike dhe vendimmarrje, roli i Institucioneve Supreme të Auditimit është thelbësor që inovacioni të mbetet në përputhje me ligjshmërinë, efikasitetin dhe transparencën.

Kontrolli i Lartë i Shtetit u përfaqësua në këtë aktivitet nga z. Rodjan Alimerkaj, i cili e ndoqi konferencën në platformën online, duke konfirmuar angazhimin institucional të KLSH-së në zhvillimet më të fundit ndërkombëtare në fushën e auditimit dhe teknologjisë.




Në konferencë, nga drejtues të lartë të institucioneve supreme të auditimit dhe organizatave ndërkombëtare, u theksua se “Inteligjenca Artificiale” nuk synon të zëvendësojë audituesit, por të rrisë ndjeshëm kapacitetet analitike, efikasitetin operacional dhe cilësinë e gjetjeve.

Një vëmendje e veçantë iu kushtua përdorimit praktik të AI-së në auditim, përmes prezantimeve mbi mjetet analitike, automatizimin e proceseve audituese dhe ndërtimin e metodologjive të posaçme për auditimin e sistemeve të bazuara në AI.

Konferenca nxori në pah rreziqet dhe sfidat e paraqitura nga “Inteligjenca Artificiale” në auditimin e sektorit publik, duke promovuar njëkohësisht shkëmbimin e njohurive, ndërtimin e kapaciteteve dhe bashkëpunim midis Institucioneve Supreme të Auditimit për auditim publik më efektiv.

Konferenca “AI in State Audit” konfirmoi se “Inteligjenca Artificiale” tashmë është një komponent kyç i modernizimit të auditimit publik. Pjesëmarrja e KLSH-së dhe angazhimi në projektet ndërkombëtare të auditimit të AI-së dëshmojnë orientimin strategjik të institucionit drejt forcimit të kapaciteteve profesionale, rritjes së cilësisë së auditimit dhe garantimit të llogaridhënies në epokën digjitale.



Një pikë kryesore e konferencës ishte prezantimi i auditimit paralel të organizuar nga EUROSAT mbi “Inteligjencën Artificiale”, i kryer nën udhëheqjen e SAI-t të Izraelit në bashkëpunim me Institucionet Supreme të Auditimit të Shqipërisë, Estonisë, Francës, Italisë, Letonisë, Lituanisë, Maqedonisë së Veriut, Polonisë, Rumanisë, Sllovakisë dhe Zvicrës.

Forcimi i kapaciteteve të auditimit të brendshëm në sektorin publik

Në datën 10 shkurt 2026, në ambientet e Hotel Rogner në Tiranë u organizua nga SIGMA/OECD, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, konferenca “Forcimi i kapaciteteve të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, në të cilën u prezantua Manuali i ri i Auditimit të Brendshëm.

Të pranishëm në këtë aktivitet ishin znj. Ritva Heikinen, kreu i Delegacionit të Bashkëpunimit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, z. Ferdinand Pot, Përfaqësues i Lartë i SIGMA/OECD, z. Manfred van Kesteren, ekspert i SIGMA, Zëvendësministri i Financave, z. Andi Memeti, përfaqësues të grupit të punës të përgatitjes dhe përditësimit të Manualit të Auditimit të Brendshëm si dhe drejtues të Njësisë të Auditimit të Brendshëm në rang vendi. KLSH u përfaqësua në këtë aktivitet nga znj. Jorida Zhegu, audituese në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm në KLSH.

Në këtë aktivitet u prezantuan edhe risitë e Manualit të Brendshëm, që konsistojnë në mënyrën se si angazhohet dhe menaxhohet procesi i auditimit, duke përcaktuar unifikimin dhe shtimin e formateve dhe cilësisë së auditimit në çdo proces; përputhshmërinë me Standardet Globale të Auditimit të Brendshëm (GIAS); dokumentim të detajuar dhe të standardizuar të çdo faze auditimi; mekanizma të qartë për kontrollin e cilësisë dhe mbikëqyrjes etj.





National Audit Office



KLSH - NAO UK, bashkëpunim mbi zhvillimin e komunikimit strategjik

Përmbillet me sukses programi i mbështetjes teknike nga Zyra Kombëtare e Auditimit në Britaninë e Madhe (National Audit Office - NAO UK) mbi zhvillimin e komunikimit strategjik dhe hartimin e raporteve të auditimit.

Në datat 25 dhe 26 shkurt 2026, një ekip i NAO UK, i përbërë nga Clare Harkey, Drejtore e Marrëdhënieve me Shtypin, Lisa Dewsbury, Menaxhere e Lartë e Komunikimit dhe Natalie Lav, Audituese e Lartë, zhvilloi takimet përmbyllëse me stafin e Drejtorisë së Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë dhe auditues nga disa departamente në KLSH, duke konsoliduar kështu dhe bashkëpunimin e vendosur mes dy Institucioneve Supreme të Auditimit.



Bashkëpunimi ndërmjet KLSH dhe NAO UK përfaqëson një hap të rëndësishëm në forcimin e kapaciteteve institucionale, veçanërisht në fushën e komunikimit strategjik dhe transparencës publike. Duke u mbështetur në përvojën shumëvjeçare të NAO UK, ky partneritet synon të modernizojë dhe strukturojë qasjen e KLSH-së ndaj komunikimit me publikun dhe palët e interesit.

Ky aktivitet u mundësua falë mbështetjes së Westminster Foundation for Democracy (WFD) në kuadër të projektit "Korniza e Ballkanit Perëndimor: Investim në Qëndrueshmërinë Demokratike", i financuar nga Ambasada Britanike në Tiranë.

Bashkëpunimi i vazhdueshëm mes WFD Shqipëri, NAO UK dhe KLSH-së është fokusuar në përmirësimin e aftësive teknike në shkrimin e raporteve të auditimit dhe strategjive të komunikimit, me qëllimin për t'i bërë ato më të kuptueshme dhe më efektive në përcjelljen e mesazheve te Parlamenti, qeveria dhe publiku. Pjesë e saj ishte dhe zhvillimi i aftësive praktike, përmes përdorimit të mjeteve të ndryshme të komunikimit, si: email marketing, plane të personalizuar komunikimi, buletine informuese dhe njoftime për shtyp, për të rritur ndikimin që duhet të kenë raportet e auditimit te palët kyçe të interesit.

Në këto takime u zhvilluan sesione të përbashkëta me auditues mbi përgatitjen e përmbledhjeve ekzekutive të raporteve, identifikimin dhe formulimin e mesazheve kryesore, si dhe përcaktimin e qasjeve praktike që sigurojnë qartësi, koherencë dhe kuptueshmëri për një gamë të gjerë audiencash.








Ekspertet e NAO UK u ndalën në hartimin e një plani konkret komunikimi, për të ndikuar në mënyrë më efektive tek audiencat, duke u fokusuar në përcaktimin e mesazheve kyçe, përdorimin e një gjuhe të qartë dhe të kuptueshme, përputhjen me objektivat strategjike të KLSH-së dhe segmentimin e grupeve të interesit.



Falëminderit për leximin!



Të gjitha të drejtat e rezervuara nga KLSH

 www.klsh.org.al  E-mail: klsh@klsh.org.al info@klsh.org.al	 Kontrolli i Lartë i Shtetit  klsh_org_al  (KLSH) Albanian Supreme Audit Institution
 Rruga "Abdi Toptani" Nr.1 Tiranë	 Orari pritjeve për publikun: E hënë - E enjte: 08:00 - 16:30 E premte: 08:00 - 14:00